

PARTIA BALLI KOMBËTAR

HISTORIKU

Partia Balli Kombëtar (PBK) u rithemelua në vitin 1991 nga Abaz Ermenji, i vetmi përfaqësues i mbijetuar i këtij formacioni që nga themelimi i parë në vitin 1942. Fillimet e Ballit Kombëtar gjenden në mes të Luftës së Dytë Botërore dhe në dekalogun me dhjetë pika të formuluar nga nacionalisti liberal Mit'hat Frashëri. Ai u formua nga anëtarë të elitës së kohës që kundërshtonin si Mbretin Zog ashtu dhe komunistët që sapo kishin krijuar partinë e tyre dhe synonin të merrnin pushtetin. Dëshira nacionaliste për një Shqipëri në të cilën të bënin pjesë të gjitha krahinat shqiptare bëri që ata të shikonin një zgjidhje të cështjes së tyre kombëtare te nazistët, gjë e cila e kompromentoi luftën e tyre për çlirimin e vendit. Megjithatë, kjo parti i rezistoi kohës dhe në emigracion sepse brenda saj kishte dhe një krah të fuqishëm socialisto-agrar që kërkonin që të merrnin liderшипin e partisë pas luftës, dhe të bënin reforma demokratike në Shqipëri, rrymë në të cilën bënte pjesë dhe Abaz Ermenji. Disa prej tyre u bënë pjesë të Komitetit Shqipëria e Lirë, e cila ekzistoi si një organizatë alternative në mërgim gjatë pesë dekadave të ekzistencës së diktaturës komuniste në Shqipëri. Gjatë viteve 1950-të, PBK në mërgim u nda në dy rryma, njëra e udhëhequr nga Abas Ermenji dhe tjetra e udhëhequr nga Ali Këlcyra, i cili ishte përfaqësues i pronarëve të pasur të tokave. Me ri-krijimin e PBK-së në vitin 1991, Abas Ermenji u zgjodh lider i saj nga viti 1994 deri në vitin 1998. Gjatë kësaj periudhe dhe pavarësisht moshës së tij, Ermenji dha një kontribut të rëndësishëm për ringjalljen e krenarisë kombëtare me anë të një sërë konferencash në të gjithë vendin. Në zgjedhjet elektorale të 26 majit 1996, Ermenji kontestoi rezultatin e tyre dhe e bojkotoi parlamentin megjithëse partia e tij kishte fituar mandate si pasojë e aleancës para-elektorale me Partinë Demokratike. Në një fjalim ai i denoncoi këto zgjedhje dhe e quajti presidentin Sali Berisha si një 'Diktator Qesharak'. Gjatë zgjedhjeve të parakohëshme të vitit 1997, PBK arriti që të renditej si forca e pestë politike në vend dhe të fitonte 3 mandate deputetësh në Kuvend. Në vitet 1997 -1998 krijohet një përçarje brenda PBK ndërmjet Hysen Selfos, në atë kohë nënkryetar i partisë dhe kryetarit të saj Abas Ermenji. Kjo sjell krijimin e Partisë Balli Kombëtar Demokrat. Në vitin 1998, zgjidhet kryetar i PBK Shpëtim Rroqi. Gjatë legjislaturës së viteve 2001- 2005, PBK kishte pesë deputetë ndërmjet të cilëve Shpëtim Rroqi, Uran Metko, Alfred Cako, Brahim Bruka dhe Zef Gjoka. Në zgjedhjet e 3 korrikut 2005, PBK nuk arriti që të përfaqësohej në parlament. Kjo gjë u përsërit dhe në zgjedhjet e qershorit 2009, por PBK si pjesë e koalicionit të PD-së arriti që të përfaqësohej në qeveri në rang zëvendësministri, me kryetarin e sapo zgjedhur të saj Adriatik Alimadhi. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2013 dhe 2017, PBK nuk arriti që të fitonte mandate për në Kuvendin e Shqipërisë. Por kryetari i saj Alimadhi arriti që të bëhej deputet pas djegies së mandateve nga deputetët e PD-së dhe LSI-së.

KRYETARI - ADRIATIK ALIMADHI

BIOGRAFIA

Adriatik Alimadhi u zgjodh kryetar i PBK në vitin 2008. Ai vinte nga eksperiencia në Ministrinë e Rendit Publik. Kishte lindur më 05.07.1963 në Skrapar dhe gjatë viteve 2007-2009 kishte qenë zotërues i një studio ligjore. Në koalicion me Partinë Demokratike, pavarësisht se nuk do të fitonte asnjë mandat deputeti në Kuvend, Adriatik Alimadhi do të shërbente si zëvendësministër në Ministrinë e Transporteve. Me diegjen e mandateve të deputetëve të PD-së dhe LSI-në, në shkurt të vitit 2019, Adriatik Alimadhi do të fitonte mandatin e deputetit në Kuvend, të cilin ai do ta pranonte.

SEKRETARIATI

Kryetar - Adriatik Alimadhi

Zv.Kryetare - Majlinda Toro

Sekretar i Përgjithshëm - Arben Hoxha

Sekretar Organizativ - Kujtim Lamaj

Kryetar i Këshillit Kombëtar - Luan Myftiu

KRYESIA

Kryetar - Adriatik Alimadhi

Zv.Kryetare - Majlinda Toro

Sekretar i Përgjithshëm - Arben Hoxha

Sekretar Organizativ - Kujtim Lamaj

Kryetar i Këshillit Kombëtar - Luan Myftiu